ECMA
NDRYSHE

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-103254
Më 17.6.2015

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 17 qershor 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, për lejimin e hartimit të Planit të Hollësishëm Urban "Qendra e Re" (plotësimi dhe ndryshimi i vendimit nr. 01/011-28 të datës 25.5.2006), dhe mori këtë:

# KONKLUZION

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, për lejimin e hartimit të Planit të Hollësishëm Urban "Qendra e Re" e qytetit të Prizrenit (plotësimi dhe ndryshimi i vendimit nr. 01/011-28 të datës 25.5.2006), kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

2. Ky propozim i rekomandohet Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës për zhvillimin e procedurave të mëtutjeshme.

3. Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

4. Me këtë konkluzion të njoftohen: Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

5. Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-103254
Më 17.6.2015

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 17 qershor 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, për lejimin e hartimit të projektit të një pjese të Planit të Konservimit, dhe mori këtë:

## KON KLUZION

1. Lejohet inicimi i procedurave ligjore për hartimin e projektit të një pjese të Planit të Konservimit në këto tri lokacione dhe atë në lokacionin:

   1.1 Përreth Kishës ortodokse "Shën Premtja" dhe "Sahat Kulla",

   1.2 Përreth "Lidhjes Shqiptare të Prizrenit" dhe

   1.3 Përreth Kinemasë "Lumëbardhi";

2. Lokacionet e lartcekura përfshihen në Zonën e VI të Planit Rregullues Urban për konservim dhe zhvillim të Zonës Historike të Prizrenit nr. 01/011-6604 të datës 18.12.2008.

3. Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

4. Me këtë konkluzion të njoftohen: Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

5. Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-103254
Më 17.6.2015

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 17 qershor 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin e disa rrugëve lokale me participim ( 3 projekte), dhe mori këtë:

## KONKLUZION

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e ndërtimit të disa rrugëve lokale dhe infrastrukturë tjetër me participim ( 3 projekte), në territorin e komunës së Prizrenit, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për ndërtimin e:

   1.1 Rrugës lokale në fshatin Hoqë e Qytetit-rruga te Mulliri,

   1.2 Rrugëve lokale në fshatin Gërnçar, dhe

   1.3 Infrastrukturës para shkollës në fshatin Krushë e Vogël.

2. Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

3. Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, komuniteti si dhe Arkivi.

4. Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-103254
Më 17.6.2015

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 17 qershor 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin e rrethojave metalike të oazave të gjelbërta në qytet , dhe mori këtë:

# KONKLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e ndërtimit të rrethojave metalike të oazave të gjelbërta në qytet, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-103254
Më 17.6.2015

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 17 qershor 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin e rrugës "Besim Shala", rrugë anësore, dhe mori këtë:

# KONKLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e ndërtimit të rrugës "Besim Shala", rrugë anësore në lagjen "Jeta e Re", kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-107193
Më 17.6.2015

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b dhe d të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e mjeteve për realizimin e projektit të OJQ "Shqiponja Zoopark", kryetari i Komunës, më 17 qershor 2015, miratoi këtë:

# VENDIM

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e mjeteve për përkrahje financiare të OJQ "Shqiponja Zoopark" për realizimin e projektit të quajtur "Prizreni me Zoopark", kështu që për këtë qëllim, lejohen mjetet financiare në vlerë prej 4850 €.

2. Ky projekt është paraparë që të realizohet edhe me Planin Lokal të Veprimit në Mjedis (PLVM) dhe me Planin Lokal në Biodiversitet të Komunës së Prizrenit (PLVB).

3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve të Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

5. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, OJQ-ja e lartcekur si dhe Arkivi.

6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-103254
Më 17.6.2015

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 17 qershor 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës, për lejimin e shpalljes së tenderit për furnizim me lëndë djegëse të ngurta për nevojat e Komunës së Prizrenit, dhe mori këtë:

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës, për lejimin e furnizimit me lëndë djegëse të ngurta (dru, pelet dhe thëngjill) për nevojat e Komunës së Prizrenit, për sezonin dimëror 2015/2016, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës-Sektori Teknik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës-Sektori Teknik, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-103254
Më 17.6.2015

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 17 qershor 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e shpalljes së tenderit për rregullimin e kulmit në Shtëpinë e Malorëve në Parkun turistik "Uji i Gropuar" ("Kopana Vodë"), dhe mori këtë:

## K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e rregullimit të kulmit në objektin e Shtëpisë së Malorëve në Parkun turistik "Uji i Gropuar" ("Kopana Vodë"), kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-103254
Më 17.6.2015

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 17 qershor 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e shpalljes së tenderit për zgjerimin dhe renovimin e rrugës ekzistuese malore në fshatin Struzhe, dhe mori këtë:

# K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e zgjerimit dhe renovimit të rrugës ekzistuese malore në fshatin Struzhe, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-103254
Më 17.6.2015

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 17 qershor 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për lejimin e shpalljes së ankandit publik për shitjen e masës drunore të damkosur, dhe mori këtë

KONKLUZION

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për lejimin e shitjes së masës drunore të damkosur, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e ankandit publik për shitjen e gjithsej 1321.09 $m^3$ dru.

2. Masa drunore është damkosur nga zyrtarët dhe ekspertët e APK në këto njësi menaxhuese:

    2.1 Pashtrik- ngastra kadastrore 111, në total..............104.36 $m^3$
    2.2 Pashtrik- ngastra kadastrore 142/143, në total....... 201.48 $m^3$
    2.3 Malet e Sharrit- ngastra kadastrore 19, në total......151.25 $m^3$
    2.4 Malet e Sharrit- ngastra kadastrore 22, në total...... 28.29 $m^3$
    2.5 Malet e Sharrit- ngastra kadastrore 35, në total.......304.4 $m^3$
    2.6 Koritnik 1- ngastra kadastrore 100, në total........... 277.37 $m^3$.

3. Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

4. Me këtë konkluzion të njoftohen: Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

5. Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-103254
Më 17.6.2015

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 17 qershor 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për lejimin e shpalljes së tenderit për shitjen e masës drunore, e cila është konfiskuar nga autoritetet komunale pyjore, dhe mori këtë

KONKLUZION

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për lejimin tenderimit të masës drunore, e cila është konfiskuar nga autoritetet komunale pyjore, kështu që për këtë qëllim, lejohet shpallja e ankandit publik për shitjen e 33.90 $m^3$ dru të llojit ahu dhe pishë e djegur.

2. Shitja do të bëhet sipas specifikacionit të prezantuar të drejtorisë përkatëse.

3. Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

4. Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

5. Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-107199
Më 17.6.2015

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për mbështetjes financiare për OJQ "N'GO", kryetari i Komunës, më 17 qershor 2015, miratoi këtë:

## VENDIM

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për mbështetje të pjesshme financiare për realizimin e edicionit të pestë të Festivalit tradicional të muzikës "Ngom Fest", i cili organizohet nga OJQ "N'GO" i cili do të mbahet me 30.07-2.8.2015 në Prizren, kështu që për këtë qëllim, ky festival përkrahet me 1000 €.
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, OJQ "N'GO" si dhe Arkivi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-107201
Më 17.6.2015

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për mbështetje financiare për shënimin e "26 Qershorit - Dita Ndërkombëtare Kundër Substancave Narkotike", kryetari i Komunës, më 17 qershor 2015, miratoi këtë:

# VENDIM

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për shënimin e "26 Qershorit - Dita Ndërkombëtare Kundër Substancave Narkotike", kështu që për këtë qëllim lejohen mjetet në shumën prej 1500 €.

2. Ky projekt është i paraparë në Komponentën 4 të Politikave Rinore i quajtur "Edukimi dhe parandalimi i dukurive të dëmshme për rinin". Ky projekt do të organizohet në bashkëveprim me Këshillin Rinor, organizatat rinore, Qendrën e Rinisë, etj.

3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

5. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

Republika e Kosovës
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-106522
Më 17.6.2015

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për formimin e Komisionit për ndarjen e banesave të ndërtuara në "Petrovë" dhe të dedikuara për familjet e dëshmorëve, invalidëve të luftës, dhe të familjeve skamnore, kryetari i Komunës, më 17 qershor 2015, miratoi këtë:

VENDIM

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për formimin e Komisionit për ndarjen e banesave të ndërtuara në "Petrovë" dhe të dedikuara për familjet e dëshmorëve, invalidëve të luftës dhe të familjeve skamnore të komunës së Prizrenit.

2. Për anëtarë të këtij komisioni propozohen;
   2.1. Një anëtar nga Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale,
   2.2. Një anëtar nga, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave,
   2.3. Një anëtar nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor,
   2.4. Një anëtar nga Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve, dhe
   2.5. Një anëtar nga Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së.

3. Ky propozim i procedohet Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

4. Obligohet Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale që, pas marrjes së këtij konkluzioni, të procedojë me lëndën në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe në Kuvendin e Komunës.

5. Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdeset Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

6. Me këtë konkluzion të njoftohen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, KPF-ja, Kuvendi i Komunës, si dhe Arkivi.

7. Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-103254
Më 17.6.2015

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 17 qershor 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për lejimin e shpalljes së tenderit për lyerjen e brendshme të objektit të QPS-së, dhe mori këtë:

## K O N  K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për lejimin e lyerjes së brendshme të objektit të Qendrës për Punë Sociale në Prizren, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-107217
Më 17.6.2015

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për përkrahje financiare për OJQ "Pema", kryetari i Komunës më 17 qershor 2015, miratoi këtë:

VENDIM

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për lejimin e mjeteve për përkrahje financiare për OJQ "Pema" për zhvillimin e aktiviteteve të parapara të kësaj OJQ-je, kështu që, për këtë qëllim, lejohen mjetet financiare në shumën prej 1500 €.

2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

4. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, OJQ-ja e lartcekur si dhe Arkivi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-107219
Më 17.6.2015

Në bazë të nenit 13 dhe 58, pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin të mjeteve për mbështetje financiare për mjekim të 34 pacientëve, kryetari i Komunës më 17 qershor 2015, miratoi këtë:

VENDIM

I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për mjekim të pacientëve: 1. Turan Kaçamak, 2. Mejrem Morina, 3. Sebahate Kasumi, 4. Vait Fazliu, 5. Shpat Laçi, 6. Gazmen Krasniqi, 7. Selim Zogaj, 8. Mitat Hashani, 9. Elmaze Kukaj, 10. Zade Qerimaj, 11. Ibrahim Hoxhaj, 12. Ajete Shala, 13. Idriz Parallangaj, 14. Ajshe Kolgeci, 15. Suzana Selimko, 16. Rahmet Bajra, 17. Shqipe Kryeziu, 18. Valbona Morina, 19. Magbule Gashi, 20. Suzan Kotle, 21. Rabije Dauti, 22. Atmane Ponik, 23. Sylejman Jonuzi, 24. Arsim Gashi, 25. Fatime Abdiji, 26. Milena Andrijevic, 27. Refije Kurtishi, 28. Azemine Raça, 29. Hidajet Jelliqi, 30. Linda Hoti, 31. Samit Xhaferi, 32. Shadan Palla, 33. Pashke Spaqi dhe 34. Qamil Arifaj.

II. Për këtë qëllim, lejohen mjetet në vlerë prej 300 € për secilin prej të lartpërmendurve.

III. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve i Drejtorisë së Shëndetësisë.

IV. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

V. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, të lartcekurit si dhe Arkivi.

VI. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-107222
Më 17.6.2015

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Njësisë për të Drejtat e Njeriut, për përkrahje financiare për OJQ "Femra për Femrën", kryetari i Komunës më 17 qershor 2015 miratoi këtë:

VENDIM

1. Miratohet propozimi i Njësisë për të Drejtat e Njeriut, për përkrahje financiare për OJQ "Femra për Femrën", për mbulimin e shpenzimeve të botimit të planit komunal të veprimit për personat me aftësi të kufizuara, kështu që, për mbulimin e këtyre shpenzimeve, lejohen mjetet financiare në shumën prej 1000 €.

2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

4. Me këtë Vendim të njoftohen: Njësia për të Drejtat e Njeriut, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, OJQ-ja si dhe Arkivi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja